



Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhëniet e punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 120/18 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 110/19, 267/20, 151/21, 288/21 dhe 111/23) dhe Lajmërimin nr.19-7609/2, nr. 19-7608/2 , nr. 19-7607/2 dhe nr.19-7606/2 nga 17.07.2025 nga Ministria e Financave për mjete të siguruara financiare, lidhur me Vendimin për publikimin e shpalljes publike nr. 04-322/1 nga 18.07.2025, IN TEATRI SHQIPTAR Shkup shpall:

SHPALLJE PUBLIKE NR.02/2025
për punësim në kohë të pacaktuar

IN TEATRI SHQIPTAR Shkup ka nevojë për punësim në kohë të pacaktuar të personave ndihmës teknik:

1. KUL 0401 A03 006 dekorator ... dy (2) realizues,
2. KUL 0401 B02 002 rojtar... një (1) realizues,
3. KUL 0401 B03 001 pastrues... dy (2) realizues, dhe
4. KUL 0405 B01 006 grimier... një (1) realizues.

Kandidatët duhet t'i plotësojnë këto:

Kushte të përgjithshme:

- të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë së Veriut;
- të jenë të moshës madhore;
- të kenë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës; dhe
- me aktgjykim të plotëfuqishëm të mos u jetë shqiptuar dënim për ndalesë të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë apo detyrës.

Kushte të veçanta:

- Për vendin e punës nr.1 dhe nr.3: Më së paku arsim fillor
- Për vendin e punës nr.2 dhe nr.4: Arsim i mesëm

Kushte të tjera të veçanta:

- Për vendin e punës nr.1 dhe nr.2: Njohja e gjuhës shqipe
- Për vendin e punës nr.4: Çertifikatë për kurs, trajnim të kryer për grimier.

Orari i punës:

Orari ditor dhe javor i punës organizohet varësisht nga programi i punës, në kuadër të orarit javor të punës prej 40 orësh.

Neto rroga mujore:

- Për vendin e punës nr.1: 39.856 denarë.
- Për vendin e punës nr.2: 37.328 denarë
- Për vendin e punës nr.3: 30.199 denarë.
- Për vendin e punës nr.4: 42.080 denarë.

Afati dhe mënyra e dorëzimit të fletëparaqitjes për punësim:

Fletëparaqitja për punësim dorëzohet më së voni 5 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes.

Forma e Fletëparaqitjes për punësim mund të merret nga web faqja e IN TEATRI SHQIPTAR Shkup www.teatri.mk.

Fletëparaqitja dorëzohet në letër në arkivin e IN TEATRI SHQIPTAR Shkup çdo ditë pune nga ora 10.00 – 12.00 ose përmes postës në adresën rr.Nikolla Martinovski nr.41,

1000 Shkup. Me fletëparqitjen dorëzohen edhe dëshmitë për plotësimin e kushteve të përgjithshme dhe të veçanta:

- vërtetim për shtetësinë (jo më i vjetër se 6 muaj);
- kopje e letër njoftimit;
- vërtetim mjekësor për gjendjen e përgjithshme shëndetësore (jo më i vjetër se 6 muaj);
- vërtetim se nuk i është shqiptuar ndalesë për ushtrimin e profesionit, veprimtarisë apo detyrës (jo më i vjetër se 6 muaj);
- dëshmi për kryerjen e shkollimit përkatës (original ose kopje e verifikuar në noter)
- dëshmi për kushte të tjera të veçanta.

Mënyra e realizimit të procedurës për përzgjedhje:

Procedura për përzgjedhje përbëhet nga përzgjedhja administrative dhe intervista. Kandidatët të cilët e kalojnë me sukses selektimin administrativ, thirren në intervistë për kontroll të kompetencave të nevojshme për vendin për të cilin konkurojnë.

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet brenda afatit të përcaktuar në nenin 23 paragrafi 2 të Ligjit për marrëdhëniet e punës.